

OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I TREGUT
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE ÇËSHTJEVE KORPORATIVE

Nr. 4536 / prot.
4

Tiranë, më 31/10 /2024

Lënda: Kthim përgjigje lidhur me shkresën tuaj nr. 1899/1 datë 30.09.2024

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË ✓
Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" nr.1023, Tiranë.

I nderuar,

Në vijim të propozimit të OST nr. 4536/2 prot. datë 10.09.2024, në lidhje me Metodologjinë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike Brenda të Njëjtës Ditë Shqipëri – Kosovë”, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Në “Metodologjisë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 100 datë 27.05.2024, me qëllim reflektimin e parashikimeve që rregullojnë aktivitetet e bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda ditës ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, janë propozuar këto shtesa:

- Në pjesën hyrëse (“Duke pasur parasysh që:”), pika 6, në fund, shtohet një fjali me këtë përmbajtje: *“Metodologjia CID duhet të mbulojë shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni si për periudhën e ditës në avancë ashtu edhe të brenda të njëjtës ditë.”*
- Në pjesën hyrëse (“Duke pasur parasysh që:”), pika 8, në fjalinë e dytë:
 - pas fjalëve *“në bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë”*, shtohen fjalët *“dhe tregut brenda ditës”*
 - pas fjalëve *“në tekstin e mëtejme referuar”*, shtohet fjala *“respektivisht”*
 - pas fjalëve *“si “AL- KS DAC”*, shtohen fjalët *“dhe AL- KS IDA”*
- Në pjesën hyrëse (“Duke pasur parasysh që:”), pika 9, në fillim shtohet fjala *“Si përfundim”*
- Në Nenin 1, pika 1 shtohet paragrafi “d” me këtë përmbajtje *“Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve në harkun kohor brenda ditës”*

- Në Nenin 3, pika 3 gërma "b", pas fjalëve "bashkimit të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë (AL-KS DAC)" shtohen fjalët "dhe AL-KS IDA (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njejtës ditës Shqipëri – Kosovë)."
- Në Nenin 4, pika 1, pas togfjalëshit "AL-KS DAC" shtohen fjalët "dhe AL-KS IDA dhe"
- Në Nenin 4, pika 2, pas fjalëve "Platforma e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA (ALPEX) – EMCS" shtohen fjalët "për AL -KS DAC dhe AL -KS IDA"
- Në Nenin 5, pika 1, pas togfjalëshit "të të ardhurave neto kufitare" shtohen fjalët "AL-KS DAC dhe AL-KS IDA"

Në "Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 101 datë 27.05.2024, me qëllim reflektimin e parashikimeve që rregullojnë aktivitetet e bashkimit të tregut brenda ditës të energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, janë prozuar këto shtesa:

- Në titull, pas togfjalëshit "të ditës në avancë" shtohen fjalët "dhe bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njejtës ditë"
- Në pjesën hyrëse ("Duke pasur parasysh që:")
 - pika 5, pas fjalëve "bashkimit të tregut të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë nuk është në gjendje që të prodhojë rezultate" shtohen fjalët "dhe për IDA (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njejtës ditës Shqipëri – Kosovë) për një sistem të përbashkët komunikimi rezervë"
 - pika 7, në fund shtohet një fjali me këtë përmbajtje: "Ndërsa për IDA (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njejtës ditës Shqipëri – Kosovë) procedura rezervë do të zbatohet për një sistem të përbashkët komunikimi rezerve."
 - pika 9, pas fjalëve "Këto procedura rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë" shtohen fjalët "dhe IDA (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njejtës ditës Shqipëri – Kosovë)"
- Në Nenin 1, pika 1, në fund shtohet fjalët "dhe për IDA (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njejtës ditës Shqipëri – Kosovë) për një sistem të përbashkët komunikimi rezerve"

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, OST SHA, mbetet e gatshme për çdo sqarim të mëtejshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST SHA

Skerdi Drenova
 OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT